



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**th ë r r e t**

mbledhjen e gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **06.08.2018** dhe do të filloj në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2017 në vitin 2018;
3. Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës " Fadil Vokrri";
4. Propozimrregullore për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
5. Propozimrregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës;
6. Propozimrregullore për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
7. Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës;
8. Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës;
9. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01- më, 060/01 - 184828/18 | 27. 07. 2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Agim Kuleta

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*

